



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

2017

RAPORT
VJETOR



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

SKY TOWER
Rr. "Ibrahim Rugova"
Nr. 5, Ap 9/3
Tiranë, Shqipëri
Përgatitur nga: Sekretariati i AAB-së
Design & Layout: FCB Afirma

RAPORT VJETOR

Tabela e përmbajtjes:

Mesazh nga Kryetari	6
Organigrama	8
• Asambleja e Anëtarëve dhe Bankat Anëtare	8
• Bordi Drejtues	9
• Sekretariati	10
• Komitete Teknike	10
Anëtarët e Shoqatës	11
Përmbledhje e veprimtarive të AAB-së në vitin 2017	12
Fakte dhe shifra për 2017 - Sektori bankar në Shqipëri	13
Veprimtaritë e AAB-së	14
• Edukimi Financiar	14
• Trajnime	20
• Mbikëqyrja Bankare	24
• Komunikimi & Marrëdhëniet me Publikun	26
Evente	26
Aktivitete Sociale	33
Publikime	34
Komitetet Teknike të AAB-së	37
kontribut dhe arritje	37
Të dhëna rreth Bankave Anëtare	43
Pasqyrat Financiare	47
	48

Të nderuar lexues,

Ndërsa do shfletoni këtë raport vjetor, jam i bindur se do ta bëni me kërshtëri dhe në fund një shije e mirë do ju mbetet. Bëhet fjalë për aktivitetin e një shoqate, por është një shoqatë që nga viti në vit ka rritur personalitetin, përfaqësimin dhe kontributin e vet për industrinë bankare, për ekonominë e vendit dhe për shoqërinë.

Viti 2017 do të mbahet më shumë në mendje dhe kujtesë si viti i zgjedhjeve parlamentare, ku një parti e vetme arriti t'i fitonte ato duke ndërtuar kështu qeverinë pa koalicion me forca të tjera. Krahas me zgjedhjet, janë dy prirje të reja që morën jetë. E para, përpjekjet për të ulur borxhin publik, i cili arriti nën 70% në fund të vitit; dhe e dyta, procesi i vetingut në drejtësi. Industria bankare i përshëndet të dyja, sepse kontribuojnë në stabilitetin e vendit dhe në një shtet të së drejtës.

Për industrinë bankare arritjet më të mëdha janë në uljen e treguesit të NPL-ve dhe në treguesit e fitueshmërisë. Pas më shumë se 6 vite përpjekje, NPL u ulën në nivelin 13.2 për qind. Treguesi i kthimit nga kapitali arriti mbi 15%, edhe pse fitueshmëria nuk është e shpërndarë në të gjitha bankat. Sektori mbetet shumë mirë i kapitalizuar dhe likuid. Krenaria jonë është që industria bankare jo vetëm që nuk ka krijuar asnjë krizë, por me maturinë e vet ka shmanhur krizë. Kontributi i industrisë bankare në ekonomi dhe shoqëri është shumë dimensional.

Edhe pse kreditimi nuk ka qenë në prishmëritë më të mira, bankat nuk e kanë ulur ofertën e kredisë. Nëse me sistemin e drejtësisë dhe rregullimin ligjor të ambientit të ekzekutimit të kolateraleve do të ishin bërë hapa më të matura, edhe rezultatet më të mira nuk do të mungonin. Ne mbetemi në pritje që ministrinë përgjegjëse të konsiderojnë kundërshtitë e AAB në lidhje me udhëzimet mbi tarifën fikse dhe tarifën e suksesit për përmbaruesit gjyqësorë privatë.

Viti 2017 shënoi fillimin e procesit të konsolidimit të industrisë bankare. Të gjithë po e ndjekim jo pa kuriozitet këtë proces që, në fund të fundit, shpresojmë t'i shërbejë shëndoshjes së sektorit dhe ekonomisë.



AAB ka shtuar përpjekjet për një komunikim më efektiv përmes marrëdhënieve me publikun. Ne kemi qenë të pranishëm në tavolina të ndryshme duke qenë partnerë seriozë të institucioneve shtetërore dhe atyre ndërkombëtare, si FMN, BB, BE, BERZh, IFC, etj. dhe veprimtaritë tona janë pasqyruar nga media.

Në emër të Bordit Drejtues, unë falënderoj të gjithë anëtarët e AAB-së për kontributin e tyre, anëtarët e Bordit Drejtues për kënaqësinë dhe pasionin e treguar në përmbushjen e detyrës, stafin e Sekretariatit që mban çdo ditë ritmin e punës si dhe ish Kryetarin e AAB-së, z. Periklis Drougkas, për angazhimin e tij të veçantë në drejtim të AAB-së.

Duke ju ftuar që të njiheni me aktivitetin e AAB-së, po ju shoqëroj në leximin tuaj me premtimin se dhe më mirë dhe më shumë do të bëjmë në vijim.

Lexim të këndshëm!

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Silvio Pedrazzi'.

Me respekt,
Silvio Pedrazzi
Kryetar

Asambleja e Anëtarëve*

*Asambleja e Anëtarëve përbëhet nga përfaqësuesit e Bankave Anëtare.
Lista e mëposhtme përshkruan në detaje bankat anëtare të AAB-së dhe Asamblenë e Anëtarëve:*

Alpha Bank Albania / George Papanastasiou, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Amerikane e Investimeve / Andi Ballta, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Kombëtare Tregtare / Seyhan Pencabligil, Drejtor i Përgjithshëm

Credins Bank / Maltin Korkuti, Drejtor i Përgjithshëm

Credit Bank of Albania / Sherine Kamel, Drejtor i Përgjithshëm

First Investment Bank Albania / Bozhidar Todorov, Drejtor i Përgjithshëm

International Commercial Bank / Gideon Van Der Broek, Drejtor i Përgjithshëm

Intesa Sanpaolo Bank Albania / Silvio Pedrazzi, Drejtor i Përgjithshëm

NBG Bank Albania / Ioannis Agathos, Drejtor i Përgjithshëm

Procredit Bank / Adela Leka, Zëdhënëse e Bordit Drejtues

Raiffeisen Bank Albania / Christian Canacaris, Drejtor i Përgjithshëm

Société Générale Albania / Frederic Blanc, Drejtor i Përgjithshëm

Tirana Bank / Dritan Mustafa, Drejtor i Përgjithshëm

Union Bank / Gazmend Kadriu, Drejtor i Përgjithshëm

United Bank of Albania / Muhamed Prlja, Drejtor i Përgjithshëm

Veneto Bank / Pierluigi Caferri, Drejtor i Përgjithshëm

* Sipas dhjetorit 2017



Anëtarët e Bordit Drejtues*

Anëtarët e Bordit Drejtues zgjidhen nga Asambleja e Anëtarëve për një mandat dy vjeçar. Anëtarët që e kanë përfunduar mandatin e tyre kanë mundësi të rizgjidhen.

Andi BALLTA, Anëtar / Drejtor i Përgjithshëm, American Bank of Investments

Maltin KORKUTI, Anëtar / Drejtor i Përgjithshëm, Credins Bank

Silvio PEDRAZZI, Kryetar / Drejtor i Përgjithshëm, Intesa Sanpaolo Bank Albania

Adela LEKA, Zëvendës Kryetare / Zëdhënëse e Bordit Drejtues, Procredit Bank Albania

Bozhidar TODOROV, Anëtar / Drejtor i Përgjithshëm, Fibank Albania

Dritan MUSTAFA, Anëtar / Drejtor i Përgjithshëm, Tirana Bank

* Sipas muajit shkurt 2018

(Nga e majta në të djathtë)

Sekretariati

Veprimtaritë e përditshme të Sekretariatit drejtohen nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Bordi Drejtues. Disa nga detyrat e Sekretariatit, të cilat do të drejtohen nga Sekretari i Përgjithshëm, janë:

Të zbatojë vendimet e Asamblesë.

Të sigurojë që anëtarët të njoftohen për vendimet e Asamblesë së Anëtarëve dhe të Bordit Drejtues dhe për zbatimin e këtyre vendimeve.

Të përmbushë detyrat që i janë ngarkuar nga Bordi Drejtues.

Të përfaqësojë AAB në organet qeveritare, në gjykatë dhe me palë të treta (sipas autorizimeve), në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Të vendosë në zbatim buxhetin vjetor dhe planin të biznesit.

Të përgatisë informacione që do të publikohen nga Shoqata dhe t'ia dërgojë ato Bordit Drejtues.

Të mbikëqyrë llogaritë e AAB-së dhe të bashkëpunojë me audituesin.

Të përgatisë dhe të nënshkruajë pasqyrat financiare të AAB-së.



Spiro Brumbull
Sekretari i përgjithshëm i AAB-së

Komitetet Teknike

- Komiteti i Sigurisë Fizike
- Komiteti i Kartave
- Komiteti i Përputhshmërisë
- Komiteti i Burimeve Njerëzore
- Komiteti i Sigurisë së Informacionit
- Komiteti i Auditit të Brendshëm
- Komiteti Ligjor
- Komiteti i Marrëdhënieve me Publikun
- Komiteti i Sistemeve të Pagesave
- Komiteti i Thesarit dhe Tregut Financiar
- Komiteti i Menaxhimit të Riskut
- Komiteti i Teknologjisë së Informacionit



ANËTARËSIMET E SHOQATËS

AAB-ja është anëtare, anëtare e asociuar ose partnere në organizatat e mëposhtme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Anëtarësimet Ndërkombëtare

Federata Evropiane e Bankave (EBF)

Shoqata Evropiane e Trajnimeve Bankare & Shërbimeve Financiare (EBTN)

Shoqata e Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore (BACEE)

Forumi i Shoqatave të Bankave INTERBALKAN

Anëtarësimet Kombëtare

Këshilli Ekonomik Kombëtar

Këshilli Tatimor

Këshilli Ekonomik i Bashkisë së Tiranës

ICC Albania

Këshilli Kombëtar i Punës

Komiteti i Sistemit Kombëtar të Pagesave

PËRMBLEDHJE E AAB-SË

Gjatë vitit 2017, Asambleja e Anëtarëve zhvilloi 5 mbledhje të rregullta dhe Bordi Drejtues zhvilloi 4 mbledhje.

Në janar, AAB-ja prezantohet me një logo të re. Në logon e AAB-së janë stampuar tre monedha të ndërlidhura me njëra-tjetrën, që përfaqëson unitetin e zhvillimit të interesave të tregut bankar.

Në shkurt, për herë të parë, zhvillon punimet Forumi për Veprimtarinë Bankare për Individë, organizuar nga AAB-ja.

Themelohet komiteti për Menaxhimin e Riskut, i cili zhvilloi takimin e parë të tij më 28 shkurt.

Në qershor, u publikua faqja e re e internetit e AAB-së. Faqja e përditësuar e internetit përfshin ndryshime në mënyrën e lundrimit, me menu zgjedhjeje vertikale si për versionin në celular, ashtu edhe për kompjuter, dhe duke ofruar qasje të përmirësuar në informacionet e publikuara.

Në shtator, u finalizua studimi “Kontributi i bankave në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare”. Gjetjet e këtij studimi u prezantuan në konferencën e organizuar nga AAB-ja në muajin nëntor. Studimi u krye nga shoqëria kroate Op2M.

Më 13 shtator, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë (SHSSH), dhe Shoqata e Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve (SH.SJ.P.FI) nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit.

Në shtator, u hap një sistem i ri online në faqen zyrtare të internetit të AAB-së, me qëllim përpunimin e të dhënave statistikore.

Në muajin tetor, u organizuan Forumi “Menaxhimi i burimeve njerëzore në bankingun digjital” dhe Forumi i dytë i auditit të brendshëm: “Përgjegjshmëria ndaj grupeve të interesit”.

Më 14 nëntor, AAB-ja organizoi konferencën “Bankat dhe rritja ekonomike”.



FAKTE DHE SHIFRA 2017

Sektori Bankar në Shqipëri

Vëllimi i kredisë në lekë për sektorin privat u rrit 7.2%.

Depozitat në fund të vitit rezultuan rreth 1.5% më të larta se një vit më parë. Stoku i tyre vlerësohet në rreth 71% ndaj PBB-së.

Kredia në valutë zbriti në 56% të portofolit të kredisë.

Norma mesatare e interesit tek kreditë për biznese ra nga 7.6% në vitin 2016 në 6.7% në vitin 2017.

Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit shënoi 16.6%.

Raporti i kredive me probleme shënoi 13.2%, nga 18.2% në fund të vitit 2016.

Rritje e konsiderueshme prej 26.32% e vëllimit të pagesave “home banking” dhe e vlerës së këtyre transaksioneve prej 60.11%, krahasuar me një vit më parë.

Treguesit e rentabilitetit konfirmuan trendin rritës, ku kthimi nga kapitali (ROE) shënoi 7.24% dhe kthimi nga aktivet (ROA) shënoi 1.58%.

Edukimi Financiar

AAB-ja mendon se nëse njerëzit marrin një edukim të përshtatshëm financiar, ata do të marrin vendime të zgjuara për financat e tyre.

Ky seksion është një përmbledhje e disa prej nismave të ndërmarra në kontekstin e edukimit financiar gjatë vitit 2017.

Leksione të hapura dhe takime me studentë

Më 9 mars, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së mbajti një leksion të hapur me temë “Bankat, ekonomia dhe biznesi” në Universitetin Evropian të Tiranës me pjesëmarrjen e studentëve nga Fakulteti Financë - Bankë dhe studentëve që ndjekin programet Master.

Më 5 prill, Sekretari i Përgjithshëm AAB-së organizoi një leksion të hapur me temë “Sistemi bankar në Shqipëri”. Në këtë leksion morën pjesë studentët e Fakultetit të Administrimit të Biznesit dhe të Informatikës Ekonomike në Universitetin Metropolitan të Tiranës (UMT). Gjithashtu, UMT mirëpriti nxënësit e shkollës Teknike Ekonomike, të cilët u bënë pjesë e leksionit në kuadër të lëndës “Paraja dhe Banka” që zhvillojnë në gjimnaz.



Më 30 maj, një grup studentësh nga Fakulteti i Financës dhe Ekonomisë në Universitetin Epoka vizituan ambientet e AAB-së. Studentët u pritën nga Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, i cili bëri një prezantim të AAB-së, veprimtarive të saj dhe zhvillimeve në sistemin bankar. Ky aktivitet u ndoq me pjesëmarrjen e një eksperti bankar në një leksion të hapur të organizuar me këta studentë në kuadër të Javës së Parasë. Përvojat komunitare, siç ishte kjo vizitë, kanë një ndikim të madh te studentët dhe zgjerojnë mësim-nxënien e tyre.



Prezantimi i programit

“Edukimi i punëkërkesve të rinj në sektorin bankar”

Më 5 prill u organizua ceremonia hapëse e programit “Edukimi i punëkërkesve të rinj në sektorin bankar”. Programi ofron mundësi edukimi dhe zhvillimi nëpërmjet qasjeve bashkëkohore të mësim-nxënies dhe shkëmbimeve shumë-dimensionale të përvojave. Ky program u dha 20 pjesëmarrësve të përzgjedhur mundësinë për të marrë pjesë në një numër leksionesh, si dhe mundësi për shkëmbime inter-aktive përvojash dhe ekspozim ndaj sektorit bankar. Pjesëmarrësit më të suksesshëm të programit patën mundësinë të konsideroheshin si kandidatë të mundshëm për vendet e lira të punës në këtë sektor. Ekspertë nga banka të ndryshme tregtare në Shqipëri dhe Partners Albania morën pjesë si lektorë në këtë program.



Forumi i Studentëve të Financës

Më 8 qershor, Departamenti i Financës në Universitetin Evropian të Tiranës (UET) organizoi forumin vjetor të studentëve të këtij departamenti. Forumi i quajtur “Ndërmjetësit financiarë në Shqipëri: Problematikat dhe sfidat” u organizua në formatin e një konkursi, ku anëtarët e jurisë vlerësuan me çmime prezantimet më të mira. Pjesë e kësaj jurie ishin përfaqësues nga Sekretariati i AAB-së, ABI Bank dhe Credins Bank.



Organizatat Lider në Shqipëri: Banka e Shqipërisë (BSH), Ministria e Arsimit dhe Sportit, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), Agjencia e Sigurimit të Depozitave, Junior Achievement dhe Shërbimi Kombëtar për Rininë.

Numri i fëmijëve dhe të rinjve të përfshirë: 2 200 dhe ndjekur nga mbi 25 000 individë.

Numri i organizatave pjesëmarrëse: 60

Numri i aktiviteteve: 17

E hënë, 27 mars 2017

Ceremonia e hapjes së Javës Globale të Parasë u organizua në Muzeun e Bankës së Shqipërisë. Të pranishëm ishin përfaqësues të nivelit të lartë të institucioneve financiare dhe medias. Po ashtu të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe shumë të rinj nga shkolla 9-vjeçare, gjimnaze dhe universitete të ndryshme të Tiranës. Në fjalën e tyre përshëndetëse, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Ministrja e Arsimit dhe Sportit dhe Kryetari i AAB-së theksuan, ndër të tjera, misionin e kësaj jave, që është ndërgjegjësimi i brezit të ri për të qenë qytetarë të përgjegjshëm financiarisht në të ardhmen. Gjithashtu, gjatë këtij aktiviteti u shpallën edhe fituesit e tre konkurseve të prezantuara një muaj më parë në “Facebook” nga BSh dhe AAB, të cilat përfshinin:

Konkursi me vizatime “Paraja ime”, ku morën pjesë më shumë se 500 nxënës nga klasa e parë në të tretën, nga 35 shkolla. U përzgjedhën 10 fitues. Konkursi u mbështet nga FIBank Albania.

Konkursi për videon më të mirë “Kursë për ditë të vështira! Kursë për ditë më të mira!”, ku u paraqitën 14 video nga nxënës të shkollave të mesme në vend, dhe u përzgjedhën 3 fitues. Ky konkurs u mbështet nga Credins Bank.

Konkurs për esenë më të mirë “A duhet të jetë i detyrueshëm edukimi financiar në planin akademik mësimor?”, ku morën pjesë 19 studentë të vitit të tretë bachelor për financë-bankë nga universitete të ndryshme të vendit, dhe u përzgjedhën 3 fitues. Ky konkurs u mbështet nga Union Bank.

Leksion i hapur në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan, ku morën pjesë 70 studentë të degës Financë-Bankë. Ky leksion u mbajt nga përfaqësues të Bankës së Shqipërisë dhe Tirana Bank.





E martë, 28 mars 2017

Konkursi “Sikur të ishim bankierë” me studentë të tre fakulteteve ekonomike nga TBU, Luarasi dhe Universiteti i Tiranës, u organizua në bashkëpunim me Qendrën Rinore të Tiranës dhe synonte të kuptuarit e bankingut dhe operacioneve të përditshme të saj nga pikëpamja praktike. Tre ekipe konkurruan me njëri tjetrin, duke e paraqitur veten si bankierë dhe duke i ofruar klientit (një shoqërie që ndërton hidrocentrale) ofertën më të mirë financiare. Të gjithë studentët u këshilluan paraprakisht me përfaqësuesit e AAB-së, BSh-së dhe BKT-së rreth rastit studimor dhe karakteristikave të konkursit. Ekipi i TBU-së u shpall fitues i konkursit. Ky aktivitet u ndoq nga më shumë se 85 studentë.

E mërkurë, 29 mars 2017

Pjesa teatrale “Biçikleta e kuqe” në Teatrin Kombëtar Eksperimental për nxënësit e shkollave fillore (klasat e treta dhe të katërta), e cila u mësoi këtyre nxënësve rëndësinë e të kursyerit. 850 nxënës morën pjesë në shfaqje, e cila u shfaq në skenë katër herë gjatë javës së parasë. Sponsor i kësaj shfaqjeje ishte Raiffeisen Bank.

U organizuan vizita në banka, në bashkëpunim me BSh-në dhe studentët e shkollës së mesme “Qemal Stafa”, të cilët kanë zgjedhur modulën “Financat Personale në duart tuaja” si pjesë e planit të tyre mësimor akademik. Alpha Bank Shqipëri mirëpriti 30 nxënës në ambientet e degës së tyre kryesore në Tiranë.

Ekspozita me temë “Edukimi financiar përmes artit” u organizua në Galerinë “Fab” me piktura të 30 nxënësve që punuan nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e piktorit Kosta Zhongo. Nxënësit shprehën botëkuptimin e tyre financiar nëpërmjet artit të tyre. Ky aktivitet u sponsorizua nga Tirana Bank.





E enjte, 30 mars 2017

Vizita në Muzeun e Bankës së Shqipërisë nga 125 nxënës nga shkolla fillore “Dora D’Istria”, shkolla e mesme “Sami Frashëri” dhe studentë të Universitetit Bujqësor Kamëz.

Kampi i Novacionit u organizua në bashkëpunim me Junior Achievement (JA) of Albania dhe Bankën e Shqipërisë dhe falë sponsorizimit dhe mbështetjes së Alpha Bank Shqipëri. Në këtë kamp morën pjesë 30 nxënës të klasave të 11-ta të rrejtit JA nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, të cilët u grupuan në 6 ekipe për të parashtruar zgjidhje novatore për sfidën e prezantuar nga AAB-ja, “Si t’u mundësojmë bankave rritjen e bazës së klientëve, duke përmirësuar teknikat e marketingut nëpërmjet përdorimit të teknologjisë celulare”. Gjatë gjithë asaj dite, ekipet gëzuan mbështetjen e përfaqësuesve të Bankës së Shqipërisë, Alpha Bank Shqipëri, Societe Generale Albania, Raiffeisen Bank dhe Tirana Bank.

Leksion i hapur me 100 studentë të Universitetit Epoka në Tiranë, i zhvilluar nga përfaqësues të Bankës së Shqipërisë dhe bankës Societe Generale Albania.



E premte, 31 mars 2017

U organizua një vizitë në Credins Bank në bashkëpunim me BSh-në dhe studentët e gjimnazit “Qemal Stafa”, të cilët kanë zgjedhur modulin “Financat personale në duart tuaja” si pjesë e planit të tyre mësimor akademik. Banka mirëpriti 30 nxënës në ambientet e degës së saj kryesore në Tiranë.

Vizita në 7 degë të Intesa Sanpaolo Bank Shqipëri, ku morën pjesë 250 nxënës nga tetë gjimnaze dhe studentë të një universiteti. Gjatë kësaj vizite, ata patën mundësinë të degjonin nga drejtuesit e degëve rreth rëndësisë së parasë dhe produkteve të ndryshme që banka ofron për klientët e saj.

Leksion i hapur në Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës me pjesëmarrjen e 90 studentëve, i zhvilluar nga përfaqësues të BSh-së dhe Intesa Sanpaolo Bank Shqipëri.

Konkursi “Financat personale në duart tuaja”. Televizioni Ora News mbështeti konkursin ndërmjet nxënësve përfaqësues të 3 gjimnazeve (“Besnik Sykja” dhe “Qemal Stafa” në Tiranë dhe “Raqi Qirinxhi” në Korçë), të cilët kanë zgjedhur modulin “Financat personale në duart tuaja” për vitin akademik 2016-2017. Konkursi synonte vlerësimin e njohurive dhe aftësive që nxënësit kanë përfituar duke studiuar këtë modul. Fitues u shpall gjimnazi “Qemal Stafa”.



Trajnime

Të mësuarit dhe zhvillimi është një nga shtyllat themelore të AAB-së. Gjatë këtyre viteve të fundit, kemi organizuar trajnime gjithnjë e më profesionale brenda vendit, në bashkëpunim me partnerët tanë të trajnimit.

2017 | U organizuan 30 trajnime
Morën pjesë 552 punonjës
Bashkëpunuam me 14 partnerë

Tema: Ligji i ri për falimentimin

Data: 07 shkurt

Pjesëmarrësit: 42

Partnerët për trajnimin/Trajnerët: Konsulentë të IFC-së

Tema: Aftësitë shitëse dhe menaxhimi i shitjeve

Data: 16-17 shkurt

Pjesëmarrësit: 17

Partner për trajnimin/Trajnerët: Instituti Austriak i Ekselencës, Eric Molin

Tema: Menaxhimi i zgjidhjes së konflikteve

Data: 20-21 shkurt

Pjesëmarrësit: 10 punonjës të bankave

Partner për trajnimin/Trajnerët: Instituti Austriak i Ekselencës, Mark Engelhardt

Tema: Menaxhimi i shpejtë i projekteve

Data: 22-24 shkurt

Pjesëmarrësit: 6 punonjës të bankave

Partner për trajnimin/Trajnerët: Instituti Austriak i Ekselencës, Mark Engelhardt

Tema: Vlerësimi dhe menaxhimi i kredive

Data: 6-8 mars

Pjesëmarrësit: 20

Partner për trajnimin/Trajnerët: Qendra e trajnimeve në Luksemburg, Eric de Jong

Tema: Të udhëheqësh me inteligjencë emocionale

Data: 28-31 mars

Pjesëmarrësit: 10

Partner për trajnimin/Trajnerët: Instituti Austriak i Ekselencës, Larissa Winter



Tema: Monitorimi mbrojtës dhe proaktiv i menaxhimit të krimit financiar

Data: 28-29 mars

Pjesëmarrësit: 19

Partner për trajnimin/Trajnerët: Instituti Shqiptar i Auditimit, Bob Pointer

Tema: Përmirësimi i Lidershipit të Qeverisjes së Korporatave

Data: 19-20 prill

Pjesëmarrësit: 8

Partner për trajnimin/Trajnerët: Instituti i Qeverisjes së Korporatave Shqipëri (CGIA) me mbështetjen e IFC-së

Tema: IFRS 9

Data: 27 prill

Pjesëmarrësit: 40

Partner për trajnimin/Trajnerët: Andrei Dochia, ekspert i PWC

Tema: Teknika dhe Instrumente për Audituesit e Brendshëm

Data: 24-26 maj

Pjesëmarrësit: 13

Partner për trajnimin/Trajnerët: Instituti Shqiptar i Auditimit, Stavri Pashko, CIA

Tema: Puna në grup - Menaxhimi i grupeve efektive

Data: 24- 25 maj

Pjesëmarrësit: 12

Partner për trajnimin/Trajnerët: Efektet e vërteta, Gila Yaniv, Eksperte dhe konsulente për zhvillimin e karrierës

Tema: Trajnim për Trajnuesit: Metodologjitë dhe Didaktika

Data: 5-7 qershor

Pjesëmarrësit: 13

Partner për trajnimin/Trajnerët: Instituti Austriak i Ekselencës, Susanne Czachs, MA

Tema: Analitikat e CRM-së sipas të dhënave kryesore

Data: 8 qershor

Pjesëmarrësit: 24

Partner për trajnimin/Trajnerët: INFIGO, Z. Davor Marić, ekspert në fushën e CRM

Tema: Incoterms®2010

Data: 8-9 qershor

Pjesëmarrësit: 9

Partner për trajnimin: ICC Albania



Tema: Bazat e tregtisë dhe financave ndërkombëtare

Data: 21-22 qershor

Pjesëmarrësit: 37

Partner për trajnimin: Programi i BERZH-it për lehtësimin e tregtisë, Z. O'Brien

Tema: Menaxhimi i riskut të kredisë nëpërmjet menaxhimit dhe monitorimit të portofolit të kredive të paguara dhe kredive me probleme

Data: 28 qershor

Pjesëmarrësit: 25

Partner për trajnimin: IFC

Tema: Anti-ryshfeti dhe anti-korrupsioni në praktikë

Data: 29 qershor

Pjesëmarrësit: 14

Partner për trajnimin: ICC Netherlands

Tema: Programi i certifikimit: Menaxhimi i Riskut në Bankë, Niveli bazë, Pjesa I dhe II

Data: 15 shtator

Pjesëmarrësit: 9

Partner për trajnimin: ATTF Luxembourg,

Tema: Rishikimi i provimit të CIA-s

Data: 2-3 tetor 2017

Pjesëmarrësit: 11

Partner për trajnimin: Instituti Shqiptar i Auditimit të Brendshëm

Tema: Të udhëheqësh me inteligjencë emocionale

Data: 4-5 tetor

Pjesëmarrësit: 12

Partner për trajnimin: Instituti Austriak i Ekselencës, Larissa Winter

Tema: Menaxhimi i riskut nga këndvështrimi i audituesëve

Data: 10-12 tetor

Pjesëmarrësit: 10

Partner për trajnimin: Instituti Shqiptar i Auditimit të Brendshëm

Tema: Kuadri mbikëqyrës i BE-së dhe prioritetet për periudhën 2017-2018, Seminar

Data: 24 tetor

Pjesëmarrësit: 44

Partner për trajnimin: Deloitte Audit Albania



Tema: Menaxhimi Efektiv
Data: 23-24 tetor
Pjesëmarrësit: 15
Partner për trajnimin: Yehuda Hamovitz

Tema: Zgjidhja e konflikteve për kërkesat për vizë
Data: 25-27 tetor
Pjesëmarrësit: 18
Partner për trajnimin: Visa Business School

Tema: Bankingu për Individë, Financat në Internet dhe Bankingu Elektronik
Data: 1-2 nëntor
Pjesëmarrësit: 15
Partner për trajnimin: Qendra e trajnimeve, Luksemburg, Pierre Voos

Tema: Vlerësimi i sigurimit të cilësisë
Data: 6-7 nëntor
Pjesëmarrësit: 10
Partner për trajnimin: Auditorët e Certifikuar Mazars

Tema: Ekselencë në Shitjen e Bonove të Thesarit
Data: 21-22 nëntor
Pjesëmarrësit: 12
Partner për trajnimin: Apollo Consulting, Z. Attila Mizsér

Tema: Seminar për programin COSME
Data: : 22 nëntor
Pjesëmarrësit: 37
Partner për trajnimin: Ministria e Financave dhe ICC Albania

Tema: Seminar për FATCA dhe Standardet e Raportimit të Përbashkët ("CRS")
Data: 30 nëntor
Pjesëmarrësit: 22
Partner për trajnimin: PWC

Tema: Menaxhimi i personave për menaxherë të ekipeve
Data: 4-7 dhjetor
Pjesëmarrësit: 18
Partner për trajnimin: Qendra e trajnimeve Luksemburg, Viviane Harnois Gilles dhe Osona de Mendez



Mbikëqyrja bankare

Çështjet rregullatore të trajtuara gjatë vitit 2017

AAB-ja trajtoi disa çështje rregullatore të rëndësishme, të cilat ndikojnë në veprimtarinë e sektorit bankar. Ndër të gjitha këto çështje, vlen të përmenden:

Udhëzimi për tarifën e përmbaruesve gjyqësorë privatë - pas ndryshimeve të kryera në vitin 2016 në Kodin e Procedurës Civile, ku, ndër të tjera, u prezantua koncepti i tarifës së suksesit për përmbaruesit, Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave nxorën një udhëzim të përbashkët nr. 385/7, datë 28.6.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat”.

AAB-ja, nëpërmjet organeve ekzekutive, e ka kundërshtuar udhëzimin dhe sidomos tarifën e larta të vendosura sipas tij, dhe në veçanti tarifën fikse, të cilat në fund do t'i ngarkohen debitorit. Shqetësimet e sektorit bankar iu prezantuan gjatë vitit 2017 të gjitha institucioneve kryesore të lidhura, kombëtare dhe ndërkombëtare, si: Kryeministrit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Për çështjet fiskale lidhur me bankat – Sekretariati i AAB-së dhe komitetet teknike të saj kanë diskutuar në hollësi lidhur me nevojat për ndryshime në kuadrin ligjor fiskal me synimin për të pasur akte rregullatore më të mira, duke i harmonizuar me praktikën më të mirë të BE-së dhe të vendeve të rajonit. AAB-ja kontraktoi PricewaterhouseCoopers Albania (PwC) si këshilltar për hartimin përfundimtar të ndryshimeve të propozuara në ligjin e tatimit mbi të ardhurat, veçanërisht lidhur me trajtimin tatimor të kolateraleve dhe riposedimin e tyre. Propozimet përkatëse iu prezantuan Ministrisë së Financave. Lidhur me këtë çështje, përfaqësuesit e AAB-së organizuan disa takime me përfaqësuesit përkatës të këtyre autoriteteve.

Për udhëzimet e nxjerra nga Ministri i Brendshëm – pas miratimit të ligjit “Për masat shpesh të sigurisë” dhe akteve e tij nënligjore, Sekretariati i AAB-së dhe komitetet teknike kanë diskutuar për çështjet kryesore lidhur me udhëzimin e Ministrit të Brendshëm dhe ua kanë prezantuar këto çështje vetë Ministrit. Ndërkohë, një tjetër shqetësim i sektorit bankar gjatë vitit 2017 ka qenë udhëzimi i nxjerrë nga Ministri i Brendshëm “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë” dhe veçanërisht lidhur me procedurat e parashikuara për transportin e vlerave monetare. Shqetësimet dhe propozimet e posaçme të sistemit bankar i janë prezantuar Ministrisë së Brendshme.

Kuadri rregullator i Bankës së Shqipërisë

AAB-ja morri pjesë në procesin e konsultimit për “Rregullore për planet e ndërhyrjeve të jashtëzakonshme” të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me ligjin 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”.

AAB-ja u përfshi duke përcjellë komente dhe sugjerime për strategjinë e de-euroizimit të miratuar nga Banka e Shqipërisë, si dhe për ndryshimet rregullatore të përcaktuara

për ta bërë veprimtarinë monetare të sektorit bankar më të kushtueshme dhe për të forcuar mekanizmat e rritjes së ndërgjegjësimit të huamarrësve.

Për më tepër, nëpërmjet komiteteve teknike, AAB-ja bashkëpunoi me Bankën e Shqipërisë dhe është përfshirë në procesin e konsultimit duke ofruar komente dhe sugjerime për:

Rregulloren e rishikuar për “Mbikëqyrjen e Konsoliduar”, e cila përcakton kushtet, rregullat dhe kërkesat rregullatore për zbatimin e mbikëqyrjes së konsoliduar sasiore dhe cilësore me qëllim menaxhimin e riskut që rrjedh nga grupi bankar dhe ai financiar.

Ndryshimet e kryera në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, e rishikuar, me qëllim që të vazhdohet zbatimi i masave që penalizojnë (në aspektin e kërkesave të kapitalit) shlyerjet e sektorit bankar ndaj personave jo rezidentë.

Ndryshimet e kryera në rregulloren “Për transparencën për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare”, e cila trajton disa nga problemet me të cilat përballet sektori bankar lidhur me transparencën ndaj klientëve, si dhe harmonizimin e mëtejshëm me direktivat evropiane për mbrojtjen e klientëve.

Rishikimin e pjesëshëm të rregullores “Për parimet bazë të bankave dhe degëve të tyre nën menaxhimin e bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”.

Ndryshimet e kryera në rregulloren “Për sistemin e kontrollit të brendshëm”, e rishikuar pjesërisht, duke u harmonizuar me ndryshimet në rregulloren “Për parimet bazë të bankave dhe degëve të tyre nën menaxhimin e bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”.

Rregullorja e re për “Fondin e ndërhyrjeve të jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”, të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë në përputhje me ligjin “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”.

Komunikimi dhe Marrëdhëniet me Publikun

Veprimtaritë janë një instrument kyç i strategjisë dhe komunikimit për AAB-në, të cilat shërbejnë për të sjellë së bashku profesionistë të industrisë bankare në vend dhe në rajon. Këto veprimtari janë një mundësi shumë e mirë për të promovuar zhvillimet që ndodhin në sistemin bankar dhe për të marrë informacione mbi ecurinë e vendeve të tjera.

Më poshtë, në këtë seksion pasqyrohen llojet e ndryshme të veprimtarive të organizuara nga AAB-ja këtë vit, të cilat janë ndarë në dy kategori: (i) aktivitete, dhe (ii) veprimtaritë sociale.

Në shumë raste, folësit ose të deleguarit e AAB-së kanë marrë pjesë në konferenca dhe kanë prezantuar pozicionin e AAB-së për secilën prej këtyre çështjeve. Në raste të tjera, është dërguar një delegat për të marrë pjesë në konferencat kryesore.

Veprimtaritë e AAB-së kanë pasur një mbulim të gjerë në media në vitin 2017 dhe Sekretari i Përgjithshëm ka dhënë më shumë se 30 intervista përgjatë gjithë vitit 2017.

Në mbrëmjen e fundvitit të AAB-së, e cila sjell së bashku të gjithë kolegët, anëtarët dhe palët e interesit, morën pjesë 60 persona.

2017 | Aktivitetet e organizuara nga AAB gjatë vitit

Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit në kuadër të Programit Kombëtar të Punësimit

Në kuadër të Programit Kombëtar të Punësimit, më 26 janar, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me 14 shoqëri publike dhe private. Kjo marrëveshje siguron shkëmbimin e shërbimeve dhe përvojave mes studentëve dhe shoqërive, në mjediset e vërteta të punës, ku pas përfundimit me sukses të këtij programi, praktikantët mund të punësohen pranë këtyre shoqërive.



Misioni i Bankës Botërore në Shqipëri

Gjatë vizitës së Misionit të Bankës Botërore për sistemet e dërgesave dhe pagesave në Shqipëri, më 26 janar u organizua një seminar me temë “Kostot e pagesave retail për përdoruesit në Shqipëri - Sa i kushton konsumatorëve, bizneseve dhe autoriteteve qeveritare në Shqipëri për të paguar?”. Veprimtaria u përqendrua në sektorin e pagesave dhe në të morën pjesë bankat anëtare të AAB-së. Gjatë këtij seminari u prezantuan gjetjet e kostove të pagesave retail për përdoruesit në Shqipëri. Gjithashtu, pjesë e kësaj agjende ishin edhe prezantimi për herë të parë i analizës racionale të orientuar ndaj ofruesit, metodologjitë dhe afatet kohore.

Forumi për Veprimtarinë Bankare për Individë

Në këtë veprimtari një-ditore u mbledhën ekspertë të huaj së bashku me politikëbërësit vendas, rregullatorët dhe përfaqësuesit e bankave në vend, të cilët diskutuan për sfidat thelbësore me të cilat po përballemi aktualisht gjatë rrugëtimit drejt transformimit dixhital. Folësit e mirënjohur kryesorë nga McKensey, Pricewaterhoues Coopers, Federata Evropiane e Bankave dhe Shoqata e Bankave Kroate shkëmbyen me pjesëmarrësit e tjerë pikëpamjet e tyre për zhvillimin e bankingut për individë si rezultat i zhvillimit të teknologjisë dhe ndryshimit të sjelljes së klientëve. Të gjithë folësit nga Banka Botërore, Banka e Shqipërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Inovacionit, Administrata Publike dhe institucione të tjera publike diskutuan rreth rreziqeve të sigurisë kibernetike, rëndësisë së byrosë së kredive, situatës aktuale në vend dhe rreth asaj që mund të përmirësohet në të ardhmen për të krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e shpejtë dhe të sigurt të bankingut për individë. Përfaqësuesit e bankave që operojnë në Shqipëri prezantuan gjithashtu përvojat e tyre në fushën e bankingut për individë.



Tryezë e rrumbullakët për menaxhimin e riskut

AAB-ja, në bashkëpunim me IFC-në, organizoi një tryezë të rrumbullakët me temë “E ardhmja e menaxhimit të riskut”. Tryeza e rrumbullakët e nivelit të lartë, e organizuar më 5 prill, ndihmoi për t’u dhënë bankave udhëzime në rrugën drejt shfrytëzimit të kapacitetit të tyre ICAAP dhe përmirësimit të kuadrit të testimit të stresit; si dhe për të kuptuar më mirë praktikatat më të mira në botë në këto fusha. Në tryezën e rrumbullakët morën pjesë përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, drejtues dhe punonjës të departamenteve të riskut të bankave anëtare, ekspertë të IFC-së, Zëvendës Drejtuesi i Misionit të Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri. “Prezantimi i ICAAP në tregun financiar shqiptar - vështrim i përgjithshëm i strategjisë”; “Rrugëtimi i praktikave më të mira të menaxhimit të riskut”; “Zhvendosja drejt një qeverisje më të mirë të riskut /përcaktimi i oreksit të riskut” - ishin disa nga temat kryesore të trajtuara në këtë takim.



SWIFT: Takimi i punës për Programin e Sigurisë së Konsumatorëve (CSP) në Shqipëri dhe takimi vjetor i UGM-së

Më 1 qershor, AAB-ja, në bashkëpunim me Shoqërinë SWIFT, organizoi takimin e punës “SWIFT: Takimi i punës për Programin e Sigurisë së Konsumatorëve (CSP)”, i cili është një program i nisur nga shoqëria SWIFT, pas sulmeve kibernetike që ndodhën në Filipine. Takimi i punës u zhvillua në 2 pjesë dhe në të morën pjesë drejtuesit e sigurisë së informacionit – CISO; drejtuesit e IT-së; personat kryesorë të kontaktit të SWIFT-it, Ministria e Financave, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve financiare jo-bankare.

Më 2 qershor, AAB mirëpriti organizimin e mbledhjes vjetore të UGM-së. Takimi u përqendrua në: Përditësimin e programit të sigurisë së klientit (CSP); Inovacioni i pagesave globale të SWIFT (SWIFTgpi); Portofoli i përputhshmërisë: Raporti i vlefshmërisë ditore; Cilësia e të dhënave të pagesave (FATF16, Rregullorja e dytë e transferimit të fondeve); Regjistri i KYC; Prezantimi dhe shërbimet e release 7.2; Botimet më të fundit të Bordit. Veprimtaria u ndoq nga përfaqësues të bankave anëtare dhe të Bankës së Shqipërisë.



Infosec dhe Analitika e të dhënave kryesore

Më 8 qershor, në bashkëpunim me INFIGO IS, u organizua veprimtaria me temë "Takimi i Infopoint - Infosec dhe Analitika e të dhënave kryesore". Në këtë veprimtari, morën pjesë profesionistë përgjegjës për Infosec, IT dhe përputhshmërinë nga bankat tregtare dhe qendrore, operatorët e telefonive celulare, shoqëritë financiare dhe të teknologjisë, ministritë, agjenci të tjera qeveritare, etj. Kjo veprimtari prezantoi tendencat më të fundit në sigurinë e informacionit nga ekspertët më kompetentë të INFIGO-s, si dhe disa nga zgjidhjet më të mira për të dhënat kryesore që INFIGO ka zhvilluar për t'iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave të ndryshme të biznesit. Përfaqësues nga Raiffeisen Bank dhe Intesa Sanpaolo Bank Shqipëri shkëmbyen përvojat dhe praktikat e tyre me audiencën.



Memorandumi i Bashkëpunimit

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë (SHSSH), dhe Shoqata e Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve (SH.SJ.P.FI) nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi. Në ceremoninë e organizuar më datë 13 shtator, morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, drejtorë të përgjithshëm të bankave dhe shoqërive të sigurimit, si dhe ekspertë të sektorit financiar. Kjo veprimtari pati një mbulim të gjerë nga media.



Si të ndërtojmë një portofol fitimprurës të biznesit të kartave

Më 22 shtator, AAB-ja organizoi një tryezë diskutimi të titulluar “Si të ndërtojmë një portofol fitimprurës të biznesit të kartave”. Mbi këtë temë u mbajtën prezantime nga përfaqësues të shoqërive VISA dhe MasterCard. Diskutimi u përqendrua në trajtimin e strategjive ose teknikave për rritjen e rentabilitetit të portofolit të kartave; informacionet më të fundit dhe udhëzimet e industrisë së kartave nga ekspertët e pagesave të shoqërive VISA dhe MasterCard si dhe historitë e suksesit dhe praktikat më të mira të ndjekura në botë. Në këtë diskutim morën pjesë përfaqësues të Bankës së Shqipërisë dhe ekspertë të bankave.



Forumi i Burimeve Njerëzore: Menaxhimi i burimeve njerëzore në bankingun digjital

AAB-ja organizoi forumin e Burimeve Njerëzore me temë: “Menaxhimi i burimeve njerëzore në bankingun digjital”. Ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të burimeve njerëzore diskutuan lidhur me aftësinë për të mësuar dhe për t’u përshtatur me ndryshimet që vazhdojnë të karakterizojë punonjësit e bankave përgjatë procesit të transformimit digjital. z. Alessandro Dordolo, Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore, Divizioni i Filialeve Ndërkombëtare të Intesa Sanpaolo Itali; znj. Larissa Winter, eksperte nga Instituti Austriak i Ekselencës, Austri; Profesor Nikos Lambridis, Krye-trajnuesi i Programit Ekzekutiv MBA, në Universitetin Sheffield, Greqi; z. Burak Yildiran, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në Bankën Garanti, Turqi, bashkë me drejtorët e bankave tona anëtare, BKT dhe Raiffeisen Bank, mbajtën fjalën e tyre në këtë forum.



Forumi i dytë i auditimit të brendshëm: Përgjegjshmëria ndaj grupeve të interesit

Forumi u organizua më 13 tetor nga Shoqata Shqiptare e Bankave në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Audituesve të Brendshëm. Pjesëmarrësit nga Banka e Shqipërisë, bankat dhe institucionet e tjera diskutuan rreth profesionit të audituesit të brendshëm në sektorin bankar në Shqipëri dhe rreth identifikimit të sfidave të zakonshme me të cilat përballlemi për të përmbushur pritshmëritë e palëve të interesit.

Ky forum ishte një mundësi e shkëlqyer për aktorët kryesorë të shprehnin pikëpamjet e tyre mbi njohuritë, perspektivat dhe rekomandimet që u nevojiten audituesve të brendshëm për ta bërë më të lehtë përmbushjen e këtyre objektivave. Përveç kësaj, u zhvilluan diskutime për sfidat e reja që rrjedhin nga perspektiva e gjithë secilit. Folës të huaj si: z. Robert Cornelisse, Drejtor i Institutit Evropian për Profesionistë të Auditit dhe Auditues i Brendshëm në Bankën Kombëtare Holandeze dhe znj. Angela Witzany, ish-kryetare e Bordit të Institutit Global të Audituesve të Brendshëm, shpalosën këndvështrimet e tyre mbi pritshmëritë dhe rolin e audituesit të brendshëm.



Konferenca e AAB-së: “Bankat dhe rritja ekonomike në Shqipëri”

Konferenca e AAB-së me temë: “Bankat dhe rritja ekonomike në Shqipëri”. Në konferencë mori pjesë Kryeministri i Shqipërisë SHTZ. Edi Rama, Ministri i Financave dhe Ekonomisë z. Arben Ahmetaj, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Gent Sejko. Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z. Enis Aliko dhe këshilltari i Ministrisë të Drejtësisë ishin pjesë e panelit të diskutimit. Përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, institucione jo bankare, drejtues të bankave, FMN, Banka Botërore, BERZH dhe përfaqësues të EFSE Development Facility (EFSE DF- i cili ishte sponsori kryesor i konferencës) morën pjesë në këtë konferencë. Të tre sesionet u drejtuan me sukses nga z. Periklis Drougkas, Kryetari i AAB-ës dhe Drejtor i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania, z. Seyhan Pencabliligil, Drejtor i Përgjithshëm dhe anëtar bordi i BKT-së; z. Dritan Mustafa, Drejtor i Përgjithshëm i Tirana Bank dhe z. Jonathan Wheatley nga IFC.



Veprimtari sociale

Veprimtari me përfaqësuesit e mediave

Më 20 janar u zhvillua takimi i Vitit të Ri me pjesëmarrjen e gazetarëve ekonomikë, analistëve dhe përfaqësuesve të mediave të organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave. Në këtë takim morën pjesë anëtarët e Bordit Drejtues, drejtorët e përgjithshëm të bankave anëtare të AAB-së, si dhe anëtarë të kryesisë së Komitetit për Marrëdhëniet me Publikun. Pjesëmarrësit shijuan një koktej, ndërkohë që mbrëmja vazhdoi në një atmosferë të ngrohtë dhe miqësore, duke krijuar lidhje dhe kontakte, me synim përmirësimin e mëtejshëm të komunikimit ndërmjet këtyre dy sektorëve.

Më 14-17 shtator, AAB-ja organizoi për të tretin vit radhazi një aktivitet me gazetarët ekonomikë. Edhe për këtë vit, aktiviteti ishte projektuar si një kombinim i një rrugëtimi trajnues dhe argëtues dhe u zhvillua në qytetin e Banskos në Bullgari. Aktiviteti u sponsorizua nga FIBank Albania.



Takimi ATTF Alumni

Më 5 dhjetor, AAB-ja organizoi në Tiranë takimin e parë të ATTF Alumni. Në këtë takim morën pjesë bankierët që kanë marrë pjesë në seminarët ndërkombëtare të ATTF për AML, ACAMS & Përputhshmërinë, Burimet Njerëzore – Menaxhimi i Personave për Menaxherët e Ekipit, Programi Ekzekutiv në Luksemburg. Pjesë e këtij aktiviteti ishin gjithashtu dy trajnerët më kryesorë të ekipit të Burimeve Njerëzore të ATTF-së, z. Ossona dhe znj. Harnois, e cila është drejtuese e programit të Burimeve Njerëzore në Luksemburg.

Më 6 dhjetor, znj. Milani zhvilloi një takim me Sekretarin e përgjithshëm të AAB-së dhe diskutoi mbi mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe trajnimeve që do të organizohen përgjatë vitit 2018.



Darka e fundvitit

Më 2 dhjetor, AAB-ja organizoi darkën e fundvitit, ku morën pjesë drejtorë të përgjithshëm dhe përfaqësues të bankave anëtare, të ftuar nga Banka e Shqipërisë - Guvernatori, Zëvendës Guvernatori i Parë, Zëvendës Guvernatori, Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes, nga departamente të tjera, Shefi i Kabinetit të Zyrës së Guvernatorit, Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe anëtarët e Bordit Botues të revistës “Bankieri”.



Publikime

Nëpërmjet botimeve periodike dhe jo periodike, AAB-ja ofron burimet e nevojshme për të informuar publikun mbi zhvillimet në sistemin bankar në përgjithësi, mbi çështjet problematike dhe veprimtaritë e ndërmarra nga Shoqata.

Raportet e rregullta përfshijnë Raportin Vjetor, Raporti CSR sipas OZHQ-ve, revista "Bankieri" dhe buletinet mujore.

Raportet mbi të dhënat specifike janë hartuar në mënyrë që të informojnë anëtarët e komitetit ose banka anëtare të veçanta mbi pikëpamjet për çështjet dhe bashkëpunimet lidhur me shërbimet financiare.

Raporti i aktiviteteve të Javës së Parasë në Shqipëri i hartuar nga Sekretariati i AAB-së pasqyroi rëndësinë që kanë botimet në këtë sektor. Ky raport qarkulloi në format elektronik në asamblenë e anëtarëve, EBF-së dhe EBTN-së.

Si përfundim, botimet mujore të përfshira në buletinet e AAB-së u shpërndanë si gjithmonë tek të gjithë anëtarët dhe komitetet e asamblesë.

Raporti vjetor 2016

Raporti Vjetor i AAB-së, i cili u botua në qershor, përfshinte zhvillimet dhe aktivitetet kryesore të Shoqatës përgjatë vitit 2016.



Raporti i CSR 2016 - Bankat për Shoqërinë

Për tre vite radhazi, AAB-ja prezanton kontributin e bankave në harmoni të plotë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Raporti konsiderohet si një standard i ri komunikimi i ngritur për ofrimin e informacionit për kontributin e bankave në shoqëri dhe ekonomi. Botimi i vitit 2017, i përgatitur me mbështetjen dhe konsulencën e EY, shpalosi një strukturë më të mirë të prezantimit dhe përmbledhjes së kontributit të bankave në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe të Përgjegjësisë Sociale të Korporatave, dhe këto objektiva prezantohen në dy seksione:

Mundësitë për vlera të përbashkëta - janë ato mundësi që përbëjnë një vlerë të shtuar për bankat, si për aksionarët, ashtu edhe për shoqërinë, që përfaqësojnë veprimet për krijimin e rrugëve më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse drejt rritjes ekonomike, prosperitetit dhe mirëqenies.

Në seksionin e Përgjegjësisë Sociale të Korporatave janë përmbledhur edhe veprimtari të tjera, të tilla si donacionet dhe sponsorizimet, të cilat nuk konsiderohen si OZHQ.



Revista “Bankieri”

Gjatë vitit 2017, u përgatitën dhe u publikuan katër botime të Revistës “Bankieri”. Revistat mund të shkarkohen nga interneti dhe në profilet përkatëse në rrjetet sociale. Për më tepër, revista u shpërnda gjerësisht tek shumë përfaqësues të institucioneve në Shqipëri.

Studimi mbi kontributin e sektorit bankar në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare

Ky studim përfshin analizën e funksionit dhe rëndësisë së bankave në mbështetje të rritjes ekonomike dhe zhvillimit social të Shqipërisë, e ndjekur me analizën e perspektivave të zhvillimit të sektorit bankar në një kontekst rajonal dhe në optikën e kontributit aktual të industrisë. Gjithashtu, janë hartuar komente në kuadër të aspekteve kyçe kritike të rëndësisë së sektorit bankar shqiptar për ekonominë e vendit.

Ky studim i krye nga Op2M, Kroaci me kërkesë të Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe u prezantua në nëntor të vitit 2017 gjatë Konferencës së AAB-së.



Video

AAB-ja vijoi me publikimin e videove informative të serisë “Banka Ime” mbi edukimin financiar:


- Kredia konsumatore
- Overdrafti
- Si të bëhesh klient i bankës
- Bankingu digjital



Faqja e internetit

Në qershor, faqja e re e internetit e AAB-së u transmetua live. Faqja e përditësuar e internetit përfshin ndryshime në mënyrën e lundrimit, me menu zgjedhjeje vertikale si për versionin në celular, ashtu edhe për kompjuterët, dhe duke ofruar qasje të përmirësuar në informacionet e publikuara.

Tani, faqja zyrtare e AAB-së përfshin një sistem të ri për përpunimin e të dhënave statistikore. Ky instrument i lejon lexuesit të vazhdojë me bazën e të dhënave duke përdorur filtra të veçanta.



Performanca e mediave sociale të AAB-së, 2017

KOMITETET TEKNIKE

Kontribut dhe arritje

Komitetet teknike kanë zhvilluar mbi **50 takime** gjatë vitit 2017 dhe çështjet e identifikuara nga këto komitete u ndoqën më tej nga Sekretariati i AAB-së.

Komiteti i Sigurisë së Bankës

Në kuadër të procesit të konsultimit të ofruar nga Policia e Shtetit, anëtarët e komitetit diskutuan disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 157, datë 01.04.2015 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”.

Pas miratimit të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” dhe udhëzimit nr. 134, datë 10.03.2017, anëtarët e komitetit u mbledhën dhe komunikuan me përfaqësuesit e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, ku u diskutua më tej mbi udhëzimin për transportin e vlerave monetare.

Në kuadër të projektit rajonal për “Shoqëritë Private të Sigurimit në Ballkanin Perëndimor” mbështetur nga Fondacioni DCAF, përfaqësuesit e komitetit morën pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga IDM-ja më 17 maj 2017, për të vlerësuar zbatimin e ligjit 75/2014 për “Shërbimin privat të sigurisë fizike dhe ndikimin në sektorin privat të sigurisë fizike: 2014-2017”, ndikimin e saj në sektorin privat të sigurisë fizike, si dhe tendencat pozitive dhe negative që janë vënë re.

Në disa takime të komitetit morën pjesë edhe ekspertët e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në sajë të takimeve të komitetit, Sekretariati i AAB-së u dërgoi shkresa zyrtare autoriteteve përkatëse (sipas çështjeve).

Më 12 shtator, pas zgjedhjeve, kryesia e komitetit përbëhej nga: Bajram Ibraj, përfaqësues i Intesa Sanpaolo Albania (Kryetar); Henri Muhaxhiri, përfaqësues i Raiffeisen Bank Albania (Zëvendës Kryetar); Rasim Borici, përfaqësues i American Bank of Investments (Zëvendës Kryetar).

Komiteti zhvilloi 9 takime gjatë vitit.

Komiteti i Kartave

Veprimtaria kryesore i këtij komiteti ishte seminari i organizuar në bashkëpunim me shoqëritë VISA dhe MasterCard, me kërkesë të bankave anëtare. Ky seminar u përqendrua në trajtimin e strategjive ose teknikave për rritjen e rentabilitetit të portofolit të kartave; informacionet më të fundit dhe udhëzimet e industrisë së kartave nga ekspertët e pagesave të shoqërive VISA dhe MasterCard si dhe historitë e suksesit dhe praktikat më të mira të ndjekura në botë.

Më 15 qershor, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së dhe kryetarja e Komitetit të Kartave zhvilluan një takim me menaxherin përgjegjës për Shqipërinë në emër të MasterCard. Gjatë këtij takimi, pjesëmarrësit diskutuan për projektet që do të ndërmerren nga shoqëria në Shqipëri dhe zhvillimet që po ndodhin në këtë fushë.

Gjatë këtij muaji, anëtarët e komitetit shpërndanë përmes postës elektronike informacione lidhur me rastet e mashtrimit që kanë ndodhur. Shkëmbimi i informacionit konsiderohet si informacion shumë i rëndësishëm për departamentet e kartave dhe sigurisë së bankave.

Gjatë takimeve të organizuara, anëtarët janë informuar rregullisht për disa mandate nga MasterCard dhe VISA, si për shembull: Përditësimi automatik i faturimit të MasterCard - Siguria e të dhënave, rritja e tarifës vjetore të programit të përputhshmërisë AML, etj.

Më 7 prill, u zhvilluan zgjedhjet për shkak të përfundimit të mandatit të kryesisë. Pas zgjedhjeve, kryesia e komitetit përbëhet nga Nevila Kovaçi, përfaqësuese e Intesa Sanpaolo Bank Shqipëri në funksionin e kryetares; Valbona Çuçka, përfaqësuese e Union Bank, dhe Imelda Koçaj, përfaqësuese e Bankës Kombëtare Tregtare, si zëvendës kryetare të këtij komiteti.

Komiteti zhvilloi 6 takime gjatë vitit.

Komiteti i Përputhshmërisë

Anëtarët e komitetit që u mblodhën gjatë vitit kanë pasur në fokus çështje teknike të ndryshme. Një ndër çështjet kryesore shqetësuese ishte projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”. Komentet dhe sugjerimet e unifikuara në projektligj iu dërguan Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Në një nga takimet morri pjesë edhe kryetari i Komitetit të Sistemeve të Pagesave. Gjithashtu, mori pjesë edhe Arlind Gjokuta, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Ai përgëzoi punën e deri më tanishme dhe veçanërisht atë të sektorit bankar si aktori dhe kontribuesi kryesor në këtë drejtim. Gjithashtu, ai shprehu angazhimin e tij të plotë për një bashkëpunim të frytshëm. Pjesëmarrësit diskutuan dhe ranë dakord për çështje teknike të ndryshme dhe mbi vizitën e ardhshme të Komitetit MONEVAL.

Lidhur me vendimin e Autoritetit Kombëtar të Konkurrencës (AKK) në lidhje me Raportin e Hetimeve të Përgjithshme në sektorin bankar, anëtarët e komitetit ranë dakord që ky vendim të përfshijë rekomandime për sektorin bankar. Ndërkohë, anëtarët trajtuan nevojën për të qenë pjesë e procesit të konsultimit, proces i cili do të niseet nga Banka e Shqipërisë për të bërë ndryshime në rregullore mbi transparencën e shërbimeve bankare, siç rekomandohet nga autoriteti kompetent.

Komiteti zhvilloi 3 takime gjatë vitit.

Komiteti i Burimeve Njerëzore

Më datë 14 tetor, u organizua forumi i Burimeve Njerëzore me temë: “Menaxhimi i burimeve njerëzore në bankingun digjital”, ku u mblodhën ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të Burimeve Njerëzore për të diskutuar mbi fleksibilitetin dhe aftësinë për t’u mësuar dhe përshtatur ndaj ndryshimit që do të vazhdojë të karakterizojë punonjësit e bankave përgjatë transformimit digjital.

Gjatë muajit mars, për vitin 2016 u dorëzua raporti mbi treguesit kryesorë të performancës së burimeve njerëzore. Në lidhje me raportin, u vendos se tanimë ky raport do të përpunohet nga Sekretariati dhe se tregues të rinj të performancës do të shtohen në të.

Komiteti u mblodh më datë 15 mars për të diskutuar propozimin e AAB-së për të marrë pjesë në sondazhin e efektivitetit të punonjësit, i cili do të zhvillohet nga Hay Group dhe ky raport do të prezantohet në forumin e ardhshëm të burimeve njerëzore të AAB-së. Sekretariati i AAB-së mblodhi të dhënat e bankave anëtare për treguesit kryesorë të performancës së burimeve njerëzore.

Më datë 27 dhjetor, Komiteti zgjodhi një kryesi të re. Kryetarja e Komitetit të Burimeve Njerëzore të AAB-së për një mandat dy-vjeçar është Entela Zigori, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore, Intesa Sanpaolo Bank Shqipëri, bashkë me dy zëvendës kryetare, Valbona Zeneli, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore, Raiffeisen Bank, dhe Gertjana Drita, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore, Tirana Bank.

Ndër çështje të tjera që u diskutuan përgjatë vitit përfshijnë prezantimin nga ana e Hay Group mbi sondazhin e efektivitetit të punonjësit dhe përfitimet e tij si dhe detajet e sondazhit të pagave; seminar mbi shpërblimin dhe paketën e kompensimit; certifikimi nga GARP në lidhje me menaxhimin e riskut (TOT), forumi i edukimit financiar dhe nismat që do të ndërmerren gjatë Javës së Parasë.

Komiteti zhvilloi 5 takime gjatë vitit.

Komiteti i Sigurisë së Informacionit

Anëtarët e Komitetit u informuan rreth ligjit të ri të sigurisë kibernetike, i cili hyri në fuqi në fund të muajit shkurt. Komiteti u drejtoi autoriteteve përkatëse çështje dhe argumente që pengojnë bankat në zbatimin e ligjit dhe për këtë u kërkoi sqarime. Gjithashtu, anëtarët shprehën gatishmërinë e tyre për t'u bërë pjesë e grupeve të punës të angazhuara në hartimin e këtyre akteve nënligjore.

Pas disa sulmesh, u diskutuan masat që do të ndërmerren dhe hetimet e kryera nga bankat. U morën vendime mbi WannaCry ransomware, që ndikon infrastrukturën e Windows/Microsoft, masat që do të ndërmerren apo masat e përdorur në përputhje me CERT EU. Gjithashtu, anëtarët u përqendruan në aktivitetet sensibilizuese që duhet të zhvillohen në kuadrin e muajit të sensibilizimit ndaj krimit kibernetik dhe masat që do të ndërmerren në kuadrin e programit të sigurisë së klientit SWIFT.

Zgjedhjet e kryesisë së Komitetit u zhvilluan më datë 25 shtator. Pas procesit të votimit, Oerd Cukalla nga Raiffeisen Bank Albania u zgjodh kryetar, ndërsa Eni Nesturi nga Banka Amerikane e Investimeve dhe Valsi Thomollari nga Alpha Bank Albania u zgjodhën zëvendës kryetarë.

Komiteti zhvilloi 3 takime gjatë vitit.

Komiteti i Teknologjisë së Informacionit

Më datë 23 mars, komiteti i AAB-së për Teknologjinë e Informacionit organizoi takimin e tij të parë. Në këtë takim, u diskutua rregullorja në bazë të së cilës do të funksionojë ky komitet si dhe u zgjodh kryesia e komitetit me përbërjen e mëposhtme: Alketa Lamce, përfaqësuese e Intesa Sanpaolo Bank si kryetare, dhe Irena Rushaj, përfaqësuese e Union Bank, dhe Altin Kona, përfaqësues i Bankës Kombëtare Tregtare, si zëvendës kryetarë të komitetit.

Komiteti zhvilloi 1 takim gjatë vitit.

Komiteti i Audituesve të Brendshëm

Anëtarët e Komitetit u përqendruan në mundësinë për të qenë më aktiv në promovimin e funksionit të auditimit të brendshëm. Komiteti diskutoi rreth muajit të sensibilizimit të auditimit të brendshëm ndërkombëtar dhe theksoi rolin e Institutit Shqiptar të Audituesve të Brendshëm, i cili nxit anëtarët të promovojnë në mënyrë aktive vlerat e auditimit të brendshëm.

Pas vendimit të komitetit për të organizuar një forum të dytë vjetor në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Auditorëve të Brendshëm, kryesia dhe përfaqësuesit e Institutit organizuan disa takime për të përcaktuar rendin e ditës. Në tetor, për të dytin vit radhazi, komiteti organizoi forumin vjetor, i cili këtë vit mbante titullin: “Përgjegjshmëria ndaj grupeve të interesit”. Për të pasur një tablo më të saktë të sfidave të funksionit të Auditimit të Brendshëm në Shqipëri dhe për ta prezantuar këtë tablo gjatë forumit, një pyetësor iu shpërnda palëve të interesit dhe audituesve të brendshëm të bankës. Rezultatet e pyetësorit u prezantuar nga kryetarja e komitetit gjatë prezantimit të saj në forum.

U zhvilluan zgjedhjet e kryesisë së Komitetit për të emëruar kryetarin e ardhshëm dhe dy zëvendës kryetarët. Pas procesit të votimit, Silvana Zoto, përfaqësuese e Bankës NBG Shqipëri, u përzgjedh në rolin e kryetares, ndërsa Dorida Stambolla, përfaqësuese e Raiffeisen Bank, dhe Daniela Hoxha, përfaqësuese e Bankës Kombëtare Tregtare, u përzgjedhën në rolin e zëvendës kryetares.

Komiteti zhvilloi 5 takime gjatë vitit.

Komiteti Ligjor

Gjatë këtij viti, anëtarët e komitetit kanë diskutuar dhe kanë bërë propozime specifike lidhur me udhëzimin e përbashkët “Për tarifat e përmbauesve privatë”, të cilat u janë prezantuar ministrive përkatëse nga AAB-ja dhe nuk janë marrë parasysh në udhëzimin e miratuar. E megjithatë, AAB-ja e ka ngritur vazhdimisht këtë çështje dhe ka dhënë deklaratat e saj për tarifat përmbaimore private. Anëtarët e komitetit kanë qenë pjesë e procesit të konsultimit për rregulloren e re të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë në përputhje me ligjin “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në procesin e konsultimit të rregulloreve të tjera të nxjerra nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2017.

Komiteti zhvilloi 1 takim gjatë vitit dhe korrespondenca e mëtejshme është shpërndarë në mënyrë elektronike.

Komiteti i Marrëdhënieve me Publikun

Aktivitetet e organizuara gjatë Javës së Parasë dhe të mbështetura nga bankat anëtare ishin një nga çështjet e diskutuara në këtë komitet. Edhe këtë vit, bankat u angazhuan për të qenë pjesë e këtyre aktiviteteve përmes sponsorizimit dhe/ose përfshirjes së stafit të tyre. Një temë tjetër e diskutuar ishte Raporti i CSR i vitit 2016 i përgatitur nga Ernst & Young (EY), në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së. Komiteti punoi mbi këtë raport të ri me temë Modeli Diagnostikues i OZHQ-së. Qëllimi i Modelit Diagnostikues të OZHQ-së është t'i ofrojë praktikantëve një kuadër për të ndihmuar bankat të diagnostikojnë gatishmërinë e organizatës së tyre në zbatim të një programi të Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Modeli ofron një panoramë të përgjithshme të panelit, bashkërendimit

aktual të bankave me nivelet e dëshiruara të bashkërendimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, e cila mund të përbëjë bazën e analizës së mangësive (gjendja aktuale dhe ajo e ardhshme) - mangësitë që përbëjnë mundësitë potenciale për përmirësim. AAB-ja e ka përgatitur këtë raport me mbështetjen e EY në Shqipëri.

Komiteti zhvilloi 2 takime gjatë vitit.

Komiteti i Sistemeve të Pagesave

Duke pasur parasysh zhvillimet më të fundit në sektorin e pagesave, më datë 31 janar, përfaqësuesit e kompanisë PayLink prezantuan platformën e tyre (propozim) në lidhje me shlyerjen e transfertave vendase në monedhën euro. Në këtë takim morën pjesë përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë dhe kryesia e komitetit së bashku me personat përgjegjës të departamenteve të IT-së.

Duke pasur parasysh kuadrin e projektit mbi “Pastrimin dhe shlyerjen e pagesave në euro brenda vendit”, nga ana e Bankës së Shqipërisë u kërkuar një studim fizibiliteti. Qëllimi i këtij studimi fizibiliteti ishte sigurimi i provave të mjaftueshme për çdo mundësi të propozuar. Për këtë qëllim, u ngrit një grup pune i cili propozoi tre mundësi: Pastrimi dhe shlyerja e ofruar nga një palë e tretë (operator privat); Pastrimi nga një palë e tretë dhe shlyerja nga Banka e Shqipërisë; Pastrimi dhe shlyerja e ofruar nga Banka e Shqipërisë.

Në takimin e organizuar më datë 15 shkurt, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së u përcollti anëtarëve të komitetit rezultatet e takimit të zhvilluar mes shoqërive të shërbimeve utilitare dhe përfaqësuesve të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave. Ky takim kishte në fokus skemën e debitimit direkt dhe palët shprehën interesin e tyre për këtë projekt. Për të diskutuar më tej lidhur me çështjet teknike, shoqëritë vendosën në dispozicion të dhënat e kontaktit për personin përgjegjës nga ana e tyre.

Komiteti iu drejtua Bankës së Shqipërisë përmes një shkrese shqetësimi në lidhje me udhëzimin nr. 22 dhe veçanërisht për përputhshmërinë me kërkesat e urdhër-pagesës së unifikuar.

Komiteti zhvilloi 5 takime gjatë vitit.

Komiteti i Thesarit dhe Tregut Financiar

Seminari për Zhvillimin e Tregut të Obligacioneve të Qeverisë së Shqipërisë ishte tema kryesore e diskutuar nga ky komitet. Një seminar i mbështetur nga Ministria e Financës, Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore u organizua si pjesë e një projekti më të madh të asistencës teknike të mbështetur nga FIRST për fuqizimin e tregut të obligacioneve qeveritare dhe menaxhimin e borxhit publik. Qëllimi i seminarit ishte të jepte mundësinë që palë të ndryshme të interesit të diskutojnë dhe bien dakord për një udhëzues të mundshëm me afate dhe përgjegjësi të qarta për zhvillimin e tregut të titujve qeveritare.

Në fund të vitit, kryesia e komitetit përbëhej nga Suela Totokoci nga Intesa Sanpaolo Bank Albania- kryetare; Donalda Gjorga nga Raiffeisen Bank, dhe Teuta Lloshi nga ABI Bank, zëvendës kryetare.

Komiteti zhvilloi 5 takime gjatë vitit.

Komiteti i Riskut

Komiteti i Riskut zhvilloi takimin e parë më 28 shkurt. Komiteti zhvilloi zgjedhjet dhe shpërndau në formë elektronike rregulloren për funksionimin e Komitetit. Kryetare e Komitetit u përzgjedh Brisilda Bala, përfaqësuese e Tirana Bank, ndërsa Gresa Panajoti, nga Banka Amerikane e Investimeve, dhe Enkelejda Ania nga Raiffeisen Bank, u përzgjedhën anëtarët e tjera të Kryesisë.

Tema kryesore e këtyre takimeve të zhvilluara gjatë vitit ishte udhëzuesi i projektit “Procesi i vlerësimit të mjaftueshmërisë të kapitalit të brendshëm” dhe SNRF 9. Pjesëmarrësit shkëmbyen praktikën e tyre më të mira dhe diskutuan për shqetësimet e përbashkëta në lidhje me zbatimin e projektit. Në këto takime morën pjesë edhe anëtarët e komitetit të riskut dhe përfaqësues të departamenteve të financës. Gjithashtu, takime të përbashkëta u organizuan edhe nga Banka e Shqipërisë.

Anëtarët u përfshinë në projektin e Byrosë së Kredive, duke plotësuar një pyetësor në lidhje me themelimin e byrosë së kredive.

Më datë 5 prill, AAB-ja, në bashkëpunim me IFC-në, organizoi një tryezë të rrumbullakët me temë “E ardhmja e menaxhimit të riskut”. Kjo tryezë e rrumbullakët e nivelit të lartë ndihmoi për t’u dhënë bankave udhëzime në rrugën drejt shfrytëzimit të kapacitetit të tyre ICAAP dhe përmirësimit të kuadrit të testimit të stresit; si dhe për të kuptuar më mirë praktikën më të mira botërore në këto fusha.

Banka e Shqipërisë, nëpërmjet Sekretariatit të AAB-së, kërkoi që bankat të jepnin mendimin e tyre për masat e propozuara në lidhje me de-euroizimin në sektorin bankar. Komiteti i riskut u mbledh më datë 30 maj për të diskutuar më tej rreth mendimeve të dërguara në Bankën e Shqipërisë.

Në ndjekje të kërkesës së Komitetit të Menaxhimit të Riskut për disa të dhëna mbi sistemin bankar që do të sigurohen nga Banka e Shqipërisë dhe pas takimit të Sekretarit të Përgjithshëm të AAB-së me Zëvendës Guvernatorin për të arritur një marrëveshje mbi këtë çështje, autoriteti në fjalë i dërgoi këto të dhëna të kërkuara. Këto të dhëna u shpërndanë tek anëtarët e komitetit dhe do t’u vijjnë në ndihmë bankave për analizat e tyre të brendshme.

Sekretariati i AAB-së u përcolli anëtarëve të komitetit të riskut platformën e AAB-së në lidhje me rregullin e ri për bankat lidhur me përdorimin e pasqyrave financiare të biznesit. Më datë 11 dhjetor u organizua një takim ku morën pjesë edhe strukturat e drejtpërdrejta të përfshira në njësitë përgjegjëse në procesin e huadhënies dhe disa nga anëtarët e Komitetit të Riskut të AAB-së me qëllim diskutimin e komenteve të dërguara.

Pas miratimit të formatit të ri të të dhënave, i cili do të dorëzohet nga bankat anëtare për përdorim të brendshëm, AAB-ja, me mbështetjen e kryetares së komitetit, hartuan draftin e parë të udhëzimeve për të raportuar këto të dhëna deri në dhjetor të vitit 2017. Të dhënat statistikore do të raportohen nga bankat në baza tremujore, sipas standardeve të PKPP dhe SNRF-së.

Komiteti zhvilloi 7 takime gjatë vitit.



TAKIME TË TJERA

Takime me Bankën e Shqipërisë

Më datë 15 shkurt, përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë (BoA) dhe Bordi Drejtues i AAB-së zhvilluan një takim diskutimi në ambientet e Bankës së Shqipërisë. Në këtë takim morën pjesë Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Gent Sejko; Zëvendës Guvernatorja znj. Natasha Ahmetaj, të tjerë zyrtarë të lartë të Bankës së Shqipërisë, Kryetari i Bordit Drejtues të AAB-së dhe Drejtori i Alpha Bank Shqipëri z. Periklis Drougkas, anëtarë të tjerë të Bordit, dhe Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së. Qëllimi i këtij takimi ishte intensifikimi i dialogut dhe bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave tregtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri, në çështjet që lidhen veçanërisht me sigurimin e zhvillimit të veprimtarisë bankare, duke marrë parasysh ngjarjet e fundit që kanë ndodhur gjatë transportimit të vlerave monetare, si dhe për të diskutuar për veprimtarinë financiare, kreditore dhe operacionale në sistemin bankar në Shqipëri.

Më 7 korrik, Bordi Drejtues i AAB-së zhvilloi një takim me Guvernatorin. Gjatë këtij takimi, pjesëmarrësit trajtuan shqetësimet e sektorit bankar në lidhje me zbatimin e projektit të SNRF 9. Gjithashtu, ata trajtuan edhe çështje të tjera që lidhen me udhëzimet e reja të tarifave të përmbaaruesve privatë. Në takim u diskutua edhe nevoja për të organizuar një takim me Kryeministrin për të shpjeguar të gjitha shqetësimet kryesore që më vonë kërkojnë ndërmarrjen e masave të nevojshme për të korrigjuar situatën e krijuar për shkak të këtij udhëzimi.

Më datë 22 shtator, me kërkesë të Bankës së Shqipërisë, u organizua takimi me përfaqësuesit e bankave dhe përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë, ku u prezantua projekt rregullorja e re mbi "Fondin e ndërhyrjeve të jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij".

Projekti i Debitimit Direkt Ndërbankar

Më datë 26 janar, në kuadër të Projektit të Debitimit Direkt Ndërbankar, u organizua një takim me pjesëmarrjen e zj. Elisabeta Gjoni, Zëvendës Guvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë, Sekretarit të Përgjithshëm i AAB-së dhe përfaqësuesit nga shoqëritë e shërbimeve utilitare (OSHE, UK Tirana, Albtelekom). Në këtë takim u diskutua marrëveshja për bashkëpunimin midis palëve të lidhura për finalizimin e këtij procesi.

Takim me ministrin e Diasporës

Dërgesat ishin tema e takimit të përfaqësuesve të Bankës së Shqipërisë, Anëtarëve të Asamblesë së AAB-së dhe Ministrit të Diasporës. Takimi u zhvillua më datë 11 dhjetor.

Rreth SNRF 9

Më 14 dhjetor, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së u takua me Zëvendës Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të diskutuar ndikimin e SNRF 9 në industrinë bankare.

Takime me përfaqësuesit e Bankës Botërore

Më datë 25 janar, përfaqësuesit e Bankës Botërore u takuan me kryesinë e Komitetit të Kartave të AAB-së dhe Komitetin e Pagesave. Takimi u përqendrua në projektin e ndërmarrë nga Banka Botërore për përfshirjen financiare. Pjesëmarrësit diskutuan rreth situatës së Shqipëri (një përmbledhje e shkurtër); risitë më të fundit të vendosura në praktikë dhe vështirësitë që lidhen me to, shërbimet financiare dhe produktet, kuadrin ligjor etj.

Sekretariati i AAB-së u takua më datë 31 janar me ekspertët e projektit përkatës për të biseduar rreth Urdhrit të Kryeministrit për Menaxhimin e Integruar të Tokës (MIT) dhe për të diskutuar ndikimin që mund të ketë ky urdhër në sektorin bankar, veçanërisht në ato fusha që kanë të bëjnë me tokën dhe tregjet e pronave (p.sh. kredi hipoteke, kredi bujqësore). Ekspertët e Bankës Botërore ishin në fazën e studimit të fizibilitetit. Gjithashtu, Sekretariati i AAB-së i erdhi në ndihmë ekipit të projektit për të marrë pikëpamjet /opinionet e bankave anëtare në lidhje me mënyrën se si banka përdor informacionet mbi vendndodhjet dhe informacionet gjeohapësinore dhe se si mund të ndryshojë kjo nëse përmirësohet saktësia e të dhënave dhe qasja në to sipas MIT-së.

Stafi i Bankës Botërore që ndihmoi Bankën e Shqipërisë në hartimin e udhëzimeve për zbatimin e ristrukturimit të huave me probleme, vizitoi Shqipërinë gjatë datave 6 - 10 mars 2017. Ky staf zhvilloi një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së dhe kryesinë e Komitetit të Riskut më datë 7 mars. Gjatë takimit pjesëmarrësit diskutuan për pengesat aktuale për zgjidhjen jashtë gjykate të kredive me probleme, fushat e identifikuar që kanë nevojë për udhëzime më të hollësishme, si dhe rëndësinë e përvojës ndërkombëtare në kontekstin e legjislacionit shqiptar dhe kuadrin rregullator.

Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së takoi më datë 9 qershor ekspertët e Bankës Botërore për mundësinë e një bashkëpunimi midis AAB-së, Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë në tregun e titujve dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve.

Më 5 tetor, u organizua një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së dhe me Bankën Botërore, fokusi i të cilit ishin projektet e mbështetura nga bankat.

Misioni i Departamentit të Vlerësimit (DV) në Tiranë

Departamenti i Vlerësimit në Tiranë (DV) në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) bëri një vlerësim të aktiviteteve të BERZH-it në sferën e mbështetjes së klimës së investimeve. Qëllimi i këtij vlerësimi u përqendrua në identifikimin e mësimave specifike të lidhura me kontekstin që mund të bëjnë që aktivitetet e ardhshme të BERZH-it të ofrojnë mbështetje më efektive dhe më efikase në fushën e klimës së investimeve. Shqipëria është një nga shtetet e operimit ku aktivitetet e bankave për periudhën 2005-2016 po analizohen në thellësi. Ekipi që vizitoi Tiranën u takua me Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së më datë 27 prill, me synim marrjen e informacioneve mbi procesin e përmirësimit të klimës së investimeve, efektivitetin dhe ndikimin e saj.

DV-ja është një departamenti i pavarur brenda BERZH-it. Ky departament është përgjegjës për të vlerësuar nëse produktet dhe shërbimet e Bankës po arrijnë rezultatet e pritura prej tyre

Takimi me FIRST Albania:

Fuqizimi i tregut të obligacioneve qeveritare dhe menaxhimi i borxhit publik

Pas seminarit mbi Zhvillimin e Tregut të Obligacioneve Qeveritare, të organizuar më 6-7 korrik 2017, konsulenti i Bankës Botërore z. Lazslo Buzas u takua me përfaqësuesit e AAB-së më datë 4 korrik 2017 në ambientet e kësaj të fundit. Z. Buzas informoi pjesëmarrësit e tjerë se Banka Botërore i ka rekomanduar Ministrisë së Financave të nisë fillimisht me emetimin e një obligacioni 5-vjeçar të standardeve që do të zëvendësojë të gjitha obligacionet e tjera 5-vjeçare të planifikuara për t'u emetuar. Ky obligacion do të emetohet drejtpërdrejtë në ankand vetëm për pjesëmarrësit e tregut që do të ishin të gatshëm të nënshkruanin një kontratë me Ministrinë e Financave. Ministria e Financave, gjithashtu, do të vendosë një komunikim të qartë me tregun dhe do të zhvillojë takime periodike me bankat pjesëmarrëse për të diskutuar planin dhe problemet e hasura. Gjithashtu, do të ndërtohet një faqe interneti për marrëdhëniet me investitorët për t'i mbajtur të hapura komunikimet me ta. Banka Botërore do të ofrojë këshillim për Ministrinë e Financave mbi rregullat për ofertat jashtë tregut (të ulëta dhe të larta) që mund të refuzohen.

Takim me përfaqësuesit e Komisionit Evropian

Më datë 9 tetor, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së u takua me z. Danielson, Drejtor i Përgjithshëm i DG NEAR në Komisionin Evropian. Gjatë këtij takimi ata diskutuan për perspektivën e Shqipërisë në kontekstin e zonës ekonomike rajonale dhe për integrimin evropian.

Takim me Këshilltarin Ekonomik Rajonal për rajonin e Danubit-Ballkanit

Më datë 12 tetor, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së u takua me z. Jean-Marie Demange, Këshilltar i Ministrit dhe Këshilltar Ekonomik Rajonal për zonën e Danubit-Ballkanit, që ndodhet në Sofje. Pjesëmarrësit në takim diskutuan për sistemin bankar në përgjithësi dhe për sfidat për vitin 2018.

Projekti i Byrosë së Kredive në Shqipëri

















Më datë 21 korrik, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së u takua me përfaqësuesit e BERZH-it për të diskutuar rreth ngritjes së Byrosë së Kredive në Shqipëri me vendim të Asamblesë së Anëtarëve. Gjatë takimit, palët shprehën shqetësimin e tyre në lidhje me reformën e nevojshme të rregullimit dhe personin përgjegjës për t'u emëruar për zbatimin e projektit. Gjatë këtij takimi, u theksua nevoja për një ekspert ndërkombëtar për ofrimin e ndihmës gjatë muajit të parë të projektit dhe periudhës së parë të zbatimit.

Në kuadër të këtij projekti, më datë 11 tetor, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së u takua me përfaqësuesin e FMN-së, i cili po ndihmon Bankën e Shqipërisë.

Shoqëria CRIF shprehu interesin e saj për të paraqitur përvojat e tyre mbi këtë çështje. CRIF është ofruesi lider botëror për infrastrukturën e informacionit të kredive bankare dhe për zgjidhjet e menaxhimit të kredive. Më datë 5 tetor, përfaqësuesit e shoqërisë u takuan me përfaqësuesit e bankave për të prezantuar përvojat e tyre mbi këtë çështje.



Të dhënat e bankave anëtare

Bank	Struktura e Aksionarëve	Vendi i origjinës	Aktivitet (€000)	Kreditë (€000)	Investime Letra me Vlerë të Qeverisë (€000)
 ALPHA BANK	Alpha Bank A.E. 100%	Greqi	577,179	239,962	96,501
 AMERICAN BANK OF INVESTMENTS	Tranzit Shpk 100%	Shqipëri	308,642	82,247	140,531
 BANKA KOMBETARE TREGTARE	Calik Finansal Hizmetler A.S. 100%	Turqi	3,057,934	979,800	1,146,876
 CREDINS bank	Renis Tershana 24.296% Aleksander Pilo 16.683% B.F.S.E Holding BV 14.482% Bank Executive Director 6.754% Other (less than 5% of shareholding) 37.785%	Shqipëri Shqipëri Hollandë Shqipëri	1,351,053	739,744	223,946
 CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT E SHQIPERISE	Kharafi Group 100%	Kuvajt	13,374	2,027	705
 First Investment Bank	Fibank AD 100%	Bullgari	157,916	71,597	52,851
 INTERNATIONAL COMMERCIA rëndësi kan	ICB Financial Group Holding 100%	Zvicër	81,567	36,799	25,776
 INTESA SANPAOLO BANK Albania	Intesa Sanpaolo S.p.A. 100%	Itali	1,160,182	350,186	430,682
 NBG Bank	National Bank of Greece S.A. 100 %	Greqi	296,650	203,101	47,624
 ProCredit Bank	ProCredit Holding AG & Co. KGaA 100%	Gjermani	256,968	171,335	13,773
 Raiffeisen BANK	Raiffeisen SEE Region Holding GmbH 100%	Austri	1,880,469	677,193	508,603
 SOCIÉTÉ GENERALE ALBANIA	Société Generale 88.89% Minority Shareholders 11.11%	Francë Shqipëri	612,404	365,167	151,396
 TIRANA BANK	Piraeus Bank 98.83% Ioannis Tzivelis 1.17%	Greqi	585,512	205,880	115,334
 UNIONBANK	Unioni Financiar Tirane (UFT) Sh.p.k. 86.34% EBRD 10.12% Individuals 3.54%	Shqipëri Britani e Madhe Shqipëri	349,658	143,660	120,872
 Banka e Bashkuar e Shqiperise United Bank of Albania	Islamic Development Bank 86.7% Ithmaar Bank 4.63% Dallah Albaraka Holding Co. 2.32% Business Focus SDN BHD 1.47% Saudi Brother Commercial Co. 0.58% Individuals 4.31%	Arabi Saudite Bahrein Bahrein Malajzi Arabi Saudite Arabi Saudite	64,644	30,164	-
 VENETO BANK GRUPPO VENETO B	Intesa Sanpaolo Group 100 %	Itali	210,728	43,406	6,132

Kapitalet e veta (€000)	Depozita (€000)	Fitimi neto (€000)	Nr. degësh	Nr. punonjësish	Nr. ATM	Nr. karta të lëshuara	Karta Debiti	Karta Krediti	Nr. POS	E-banking	Mobile Banking	E-commerce
72,035	466,931	(6,189)	34	424	50	17,918	73,415	9,933	816	Po	Po	Jo
28,773	262,853	4,402	19	248	32	14,883	14,205	678	-			
327,074	2,396,567	49,200	93	1,292	147	378,756	320,042	58,714	5,348	Po	Po	Po
114,364	1,136,389	8,160	58	857	65	78,435	74,246	4,189	683	Po	Po	Po
9,915	3,849	(2,112)	1	24	-	-	-	-	N/A	Jo	Jo	Jo
19,978	129,594	3,277	9	143	28	30,206	26,372	3,834	N/A	Po	N/A	N/A
10,529	61,002	(1,223)	5	98	5	1,132	1,132	N/A	N/A	Po	Po	Jo
148,247	960,597	12,461	32	576	49	102,024	102,024	N/A	563	Po	Po	Jo
58,095	232,120	(4,180)	26	306	34	17,257	16,845	412	-	N/A	N/A	N/A
32,261	180,867	(3,998)	7	202	25	29,818	29,497	321	300	Po	Jo	Jo
222,627	1,542,090	33,546	76	1,277	171	233,278	210,197	23,081	978	Po	Po	Po
67,515	512,948	3,030	38	413	64	49,980	49,277	703	-	Po	Po	Jo
109,026	458,497	522	39	439	69	61,755	57,634	4,121	131	Po	Po	N/A
29,141	300,306	2,563	30	377	40	33,181	28,779	4,402	30	Po	Po	Jo
10,278	54,016	(1,228)	6	79	0	0	0	0	0	Jo	Jo	Jo
23,174	177,122	(10,431)	15	123	16	11,579	11,131	448	42	Po	Jo	Jo

Të dhënat e audituara sipas IFRS, në 29.12.2017 (1 EUR =132.95 ALL)

PASQYRAT FINANCIARE TË AAB-SË

PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

PËRMBAJTJA:

PASQYRAT E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
PASQYRA E FLUKSIT MONETAR	4
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5

PASQYRAT E POZICIONIT FINANCIAR

	Shënime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<u>AKTIVET</u>			
Aktive afatshkurtra			
Arka dhe Banka	4	18,441,678	14,755,093
Shpenzime të parapaguara	5, 6, 7	1,510,130	1,713,732
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		19,951,808	16,468,825
Aktivet Afatgjata			
Aktivet e qëndrueshme, neto	8	931,706	914,482
Totali i Aktiveve Afatgjata		931,706	914,482
TOTALI I AKTIVEVE		20,883,515	17,383,307
<u>DETYRIMET</u>			
Llogari të pagueshme	9	663,968	1,305,556
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		663,968	1,305,556
Aktivet Neto	10	20,219,546	16,077,751
TOTALI I DETYRIMEVE		20,883,515	17,383,307

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

	Shënime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<u>TË ARDHURAT</u>	11		
Kuotat e anëtarësisë		39,311,000	36,984,000
Të ardhura për trajnime		5,119,088	3,717,480
Interesat nga llogaritë rrjedhëse		542,149	-
Totali i të Ardhurave		44,972,237	40,701,480
<u>SHPENZIMET</u>			
Amortizimi	6	(237,595)	(163,119)
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme	6		(17,582)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrimit	12, 13, 14	(35,766,930)	(31,629,506)
Shpenzime për trajnime	12	(4,825,917)	(3,175,176)
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit		-	-
Totali i Shpenzimeve		(40,830,442)	(34,985,383)
Teprica /Deficit i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		4,141,795	5,716,097
Aktivitet Neto në fillim të vitit		16,077,751	10,361,654
Aktivitet Neto në fund të vitit		20,219,546	16,077,751

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FLUKSIT MONETAR

	Shënim e	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<i>Fluksi i parave nga veprimtaria e shfrytëzimit</i>			
Teprica/Deficiti i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		4,141,795	5,716,097
Rregullime për:			
Amortizim	8	237,595	163,119
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme	8		17,582
Të ardhura nga interesa bankare (llogari rrjedhëse)			
Pagesa për shpenzimet e parapaguara	7	421,407	459,520
Llogari të arkëtueshme		(217,804)	(926,822)
Pagesa për llogaritë e pagueshme	9	(641,588)	371,093
Interesat nga llogaritë rrjedhëse			
Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit		3,941,405	5,800,588
<i>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese</i>			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	8	(254,820)	(371,312)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		(254,820)	(371,312)
RRITJA NETO E MJETEVE MONETARE		3,686,585	5,429,276
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	4	14,755,093	9,325,816
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	4	18,441,678	14,755,093

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) janë përpiluar në datë 29.03.2017 dhe nënshkruar nga:



Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave



Tedi ZERI

Drejtor i Departamentit të Financës

Tirana Bank

1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është themeluar më 15 Prill 1999 me seli në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 9, Ap.3, Tiranë, Shqipëri.

AAB është një shoqatë jo fitimprurëse, e cila përpiqet të promovojë standardet më të fundit Bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga 16 anëtarë, mbi baza vullnetare: Alpha Bank Shqipëri, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Societe General Albania, Banka Credins, Banka e Kreditit të Shqipërisë, FIBank Albania, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka Intesa SanPaolo Shqipëri, Banka NBG Shqipëri, Banka Pro-Credit, Raiffesien Bank Shqipëri, Tirana Bank, Banka Union, Banka e Bashkuar e Shqipërisë dhe Veneto Banka.

2. Baza e Përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me SKK për OJF-të dhe ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. SKK për OJF-të ka hyrë në zbatim nga data 1 janar 2016.

Pasqyrat Financiare paraqiten në Lek (ALL), e cila është dhe monedha funksionale e Shoqatës.

3. Përmbledhje e Politikave Kontabël

- *Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve*

Të ardhurat njihen me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme. Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë si të ardhurat që lidhen me to.

Të ardhurat kryesore të Shoqatës vijnë nga tarifat e anëtarësimit, të cilat janë subjekt i miratimit të Asamblesë së Anëtarëve.

Të ardhurat regjistrohen kur realizohen dhe shpenzimet regjistrohen kur ndodhin.

- *Transaksionet në monedhë të huaj*

AAB përdor si monedhë bazë Lek-un (ALL). Të gjitha kontributet dhe pjesa dërrmuese e shpenzimeve janë në lekë (ALL). Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin në datën e kryerjes së transaksionit. Të gjitha balancat në monedhë të huaj në fund të vitit janë konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e fundit të vitit si vijon:

Kursi i këmbimit më 31 Dhjetor

	31/12/2017	31/12/2016
Euro	132.95	135.23

- Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

Vlerësimi fillestar i elementeve që plotësojnë kriteret e njohjes si AAM në bilanc është bërë me koston e blerjes plus kostot e tjera të drejtpërdrejta, që lidhen me sjelljen e aktivit në vendndodhje dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të Shoqatës. Vlerësimi vijues është bërë sipas modelit të koston dhe AAM-të paraqiten në bilanc në vlerën neto (minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e mundshme nga zhvlerësimi, nëse ka). Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes.

Normat e amortizimit dhe metoda sipas grupeve:

	Norma e Amortizimit	Metoda e përdorur
Pajisje Informatike	25%	Vlera e mbetur
Mobilje/Orendi	20%	Vlera e mbetur
AAM të tjera	20%	Vlera e mbetur

- Tatimet dhe Taksat

AAB është një shoqëri jo fitimprurëse dhe, si e tillë, është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat personale dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore, si dhe taksave vendore.

4. Arka dhe Banka

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

Në Lek	31/12/2017	31/12/2016
Llogari rrjedhëse në lekë	17,120,898	14,571,976
Llogari rrjedhëse në euro	1,215,120	124,193
Para në arkë	105,659	58,925
Gjithsej	18,441,678	14,755,093

5. Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm

Të drejtat dhe interesi i arkëtueshëm përbëhen nga sa më poshtë:

Në Lek	31/12/2017	31/12/2016
Parapagime		91,377
Detyrime te tjera		142,695
Garanci qera	280,160	280,160
Gjithsej	280,160	514,232

6. Kontribute të arkëtueshme

Kontributet e arkëtueshme përbëhen nga sa më poshtë:

Në Lek	31 December 2017	31 December 2016
Tarifa antarësimi	1,144,626	692,750
Gjithsej	1,144,626	692,750

7. Inventarë dhe shpenzime të parapaguara

Inventarë dhe shpenzime të parapaguara përbëhen nga sa më poshtë:

Në Lek	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzime interneti		10,918
AKEP		3,833
Anëtarësim BACEE		272,100
Mirëmbajtje dhe hostim web		25,999
Hostim domain	-	-
Siguracion shëndeti	85,343	193,900
Bileta udhëtimi	-	-
Gjithsej	85,343	506,750

8. Aktivët e Qëndrueshme

Aktivët e Që159ndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

Në LEK	Mobilje / Orendi	Pajisje Kompjuterike	Gjithsej
<i>Kosto</i>			
Në 31 Dhjetor 2016	2,013,701	1,222,767	3,236,468
Shtesat gjatë vitit 2017		254,820	254,820
Pakësimi gjatë vitit 2017			
Në 31 Dhjetor 2016	2,013,701	1,447,587	3,491,288
<i>Amortizimi i Akumuluar</i>			
Në 31 Dhjetor 2016	1,505,267	816,720	2,321,987
Amortizimi gjatë vitit 2017	77,687	159,908	237,595
Pakësimi gjatë vitit 2017			
Në 31 Dhjetor 2017	1,582,954	976,628	2,559,582
<i>Vlera Neto e Librit</i>			
Në 31 Dhjetor 2016	508,434	406,048	914,482
Në 31 Dhjetor 2017	430,747	500,959	931,707

9. Llogari të Pagueshme

Llogaritë e pageshme përbëhen nga sa vijon:

Në Lek	2017	2016
Furnitorë	166,990	672,637
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	185,969	192,456
TAP	273,448	368,174
Tatim në Burim	16,400	72,259
Personeli	21,160	30
Gjithsej	663,967	1,305,556

10. Aktivët Neto

Aktivi neto është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të OJF-së në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

Ndryshimi në aktivet neto paraqitur në pasqyrën e aktiviteteve artikullohet në aktivet neto të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar.

Aktivet neto të paraqitura si të pakufizuara përdoren në periudhat vijuese vetëm për objektivat e përcaktuara në statutin e shoqatës.

Në Lek	2017	2016
Në fillim të periudhës	16,077,751	10,361,654
Rritje në aktivet neto	4,141,795	5,716,097
Humbjet nga zhvlerësimi	-	-
Vlera e bartur në vitin e ardhshëm	20,219,546	16,077,751

11. Të Ardhurat

Në Lek	2017	2016
Tarifa anëtarësimi nga bankat anëtare	39,311,000	36,984,000
Trajnim bankat anëtare	5,119,088	3,717,480
Spensorizime nga bankat	542,149	-
Gjithsej	44,972,237	40,701,480

12. Aktiviteti A – Shpenzime Organizimi

Në Lek	2017	2016
Evente dhe Tryeza pune	8,087,915	6,454,899
Anëtarësime	1,179,840	1,500,645
Udhëtime	1,432,571	679,866
Trajnime bankat anëtare	4,825,917	3,175,176
Gjithsej	15,526,243	11,810,586

13. Aktiviteti B – Shpenzime promovimi, publikime dhe reklama

Në Lek	2017	2016
Publikime	4,394,132	3,652,851
Materiale informative dhe publicitet	393,733	692,260
Gjithsej	4,787,866	4,345,111

14. Shpenzimet e përgjithshme dhe të administrimit

	2017	2016
Paga personeli	10,924,505	11,258,281
Kontribute për sigurime	1,138,539	1,114,606
Sigurim shëndeti	313,371	584,430
Qira	3,223,240	3,300,500
Shpenzime komunikimi	1,425,942	796,369
Shpenzime utilitare	139,678	204,668
Taksa lokale	15,100	15,000
Komisione bankare	40,396	82,524
Shërbime përkthimi	250,940	277,462
Kancelari dhe të tjera të konsumueshme	529,103	308,254
Abonime	13,500	191,614
Noterizime	25,000	22,140
Shpenzime të tjera	514,527	472,756
Diferenca kursi	36,550	10,310
Penalitete	2,683	10,071
Amortizimet dhe zhvlerësimet	237,595	180,701
Konsulence Financiare	1,685,665	
Gjithsej	20,516,334	18,829,686

Përgatiti:

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

PWC

Spiro Brumbulli

Price WaterhouseCooper

Sekretar i Përgjithshëm

